



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës  
Opstina Kamenica  
Kamenica Municipality

Në bazë të nenit 8 dhe 10 paragrafi 6 të Ligjit Nr.03/L-212 i Punës, dhe Kërkesës Nr.02/25173 dt.09.09.2025 nga Drejtoria për Zhvillimin Ekonomik dhe Diasporë, Komuna e Kamenicës bënë këtë:

### **SHPLLJE PUBLIKE**

Për plotësimin e pozitës për kryerjen e detyrave specifike  
(Procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit)

Titulli i pozitës: Një (1) Zyrtar për Turizëm dhe Diasporë.

Nr. i ekzekutuesve: (1) ekzekutues

Orar i punës : 40 në javë

Paga bruto mujore: 500 €.

Periudha e angazhimit: (120 ditë)

#### **Detyrat Kryesore:**

- Hartimi dhe zbatimi i strategjive për zhvillimin e turizmit në komunë.
- Promovimi i atraksioneve turistike vendore.
- Bashkëpunimi me operatorët turistikë, bizneset lokale dhe organizatat për të rritur ofertën turistike.
- Organizimi i aktiviteteve dhe ngjarjeve që nxisin turizmin lokal.
- Të mirëmbajë databazë të bizneseve të diasporës
- Organizon takimet me shoqatat e diasporës
- Merret me koordinimin e panairëve lokale dhe ndërkombëtare për bizneset vendore dhe të diasporës.
- Hulumton për fonde investime në mes OJQ-ve vendore dhe ndërkombëtare.
- Ofrimi i informatave dhe ndihmës për qytetarët e diasporës që dëshirojnë të investojnë ose të rikthehen në komunë.
- Përcjellja e nevojave dhe shqetësimeve të diasporës dhe adresimi i tyre pranë institucioneve përkatëse.
- Përgatitja e rekomandimeve për përmirësimin e politikave komunale në lidhje me turizmin dhe diasporën.

Kërkesat e përgjithshme formale:

Diplomë e arsimit (Baçelor) Ekonomi dhe Turizem , përvoja e punës (e dëshirueshme)

Çdo kandidat (aplikues) për pozitën e lartëcekur duhet t'i komplotoj dhe dorëzoj dokumentacionin (kopje) si vijon:

Formulari i aplikimit, i plotësuar;

Dëshmi të kualifikimit Arsimor;

Dokumentin e identifikimit.

Dëshmi mbi përvojën e punës (nëse ka);

Dëshmia se kandidati nuk është i dënuar për kryerjen e një vepre penale me dashje; (lëshuar nga Gjykata Themelore, jo më i vjetër se 6 muaj);

Aplikacionet merren dhe të plotësuara dorëzohen në Qendrën për Shërbime me Qytetarë në Administratën Komunale në objektin e Komunës së Kamenicës.

Afati i aplikimit është 7 ditë, nga dita e shpalljes publike në Web faqen Komunale dhe tabelën e shpalljeve.

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike lokale”.

Në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët e përfshirë në listën e ngushtë mbi bazën e kriterëve të shpalljes Publike përmes njoftimit në Web faqe Komunale.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, kurse ato të mangëta refuzohen.

Kadri RAHIMAJ  
Kryetar i Komunës Kamenicës